



Nr. 247/19 Prot.

Tiranë, më 04 / 02 / 2019

**Lënda:** Kthim përgjigje lidhur me përcjelljen e kritereve të veçanta për pranimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2020-2021 në SHLUJ "Universiteti Marin Barleti".

**Drejtuar:** **MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**  
**DREJTORSË SË PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**  
**DREJTORISË SË PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

Në përgjigje të shkresës Suaj me Nr. 329 prot., datë 15.01.2019, protokolluar me tonën Nr. 1646 prot, datë 17.01.2019, mbështetur në Vendimin e Senatit Nr. 5/19, datë 04.02.2019 "Për miratimin e kritereve për pranimin e studentëve në programet me karakter profesional, në programet e ciklit të parë Bachelor dhe në programet e ciklit të dytë Master", ju dërgojmë kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit që ofron SHLUJ "Universiteti Marin Barleti" për vitin akademik 2020-2021, të miratuara nga Senati Akademik, si më poshtë vijon:

### **I. Për programet me karakter profesional**

1. Kriteri i pranimit për aplikim në të gjitha programet e studimit me karakter profesional është nota mesatare e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2020-2021.
2. Renditja e aplikantëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare bëhet sipas nivelit më të lartë të notës mesatare të përcaktuar në VKM; nëse nota mesatare do të rezultojë e njëjtë për më shumë se 2 aplikantë, do të merret në konsideratë nota më e lartë e provimit të Matematikës në Provimet e detyrueshme të Maturës, me përjashtim të programeve Operator në fitnes, palestër dhe organizime eventesh publike dhe Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore, për të cilët do të jetë nota më e lartë e provimit të Gjuhës së Huaj në Provimet e detyrueshme të Maturës; nëse nota do të jetë sërish e njëjtë, merret në konsideratë koha e regjistrimit të aplikantit për të vazhduar studimet në SHLUJ "Universiteti Marin Barleti".

### **II. Për programet e ciklit të parë Bachelor**

1. Kriteri i pranimit për aplikim në të gjitha programet e ciklit të parë Bachelor është nota mesatare e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2020-2021.
2. Renditja e aplikantëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare bëhet sipas nivelit më të lartë të notës mesatare të përcaktuar në VKM; nëse nota mesatare do të rezultojë e njëjtë për më shumë se 2 aplikantë, do të merret në konsideratë nota më e lartë e provimit të Gjuhës së Huaj në Provimet e detyrueshme të Maturës, me përjashtim të programit të Edukimit Fizik e Sporte;



- nëse nota do të jetë sërisht e njëjtë, merret në konsideratë koha e regjistrimit të aplikantit për të vazhduar studimet në SHLUJ "Universiteti Marin Barleti" në programin e zgjedhur.
- Renditja e aplikantëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare në programin e Edukimit Fizik e Sporte bëhet sipas nivelit më të lartë të pikëve të përlogaritur: 50% e pikëve totale (totali = 100 pikë) përcaktohen sipas notës mesatare të përcaktuar në VKM dhe 50% e pikëve përcaktohen nga testi fizik i zhvilluar pranë SHLUJ "Universiteti Marin Barleti"; nëse totali i pikëve do të rezultojë e njëjtë për më shumë se 2 aplikantë, do të merret në konsideratë nota më e lartë e provimit të Gjuhës së Huaj në Provimet e detyrueshme të Maturës; nëse nota do të jetë sërisht e njëjtë, merret në konsideratë koha e regjistrimit të aplikantit për të vazhduar studimet në SHLUJ "Universiteti Marin Barleti".

### III. Për programet e integruara të ciklit të dytë

- Kriteri i pranimin për aplikim në programin e integruar të ciklit të dytë në Arkitekturë është nota mesatare e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2020-2021.
- Renditja e aplikantëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare bëhet sipas nivelit më të lartë të notës mesatare të përcaktuar në VKM; nëse nota mesatare do të rezultojë e njëjtë për më shumë se 2 aplikantë, do të merret në konsideratë nota më e lartë e provimit të Matematikës në Provimet e detyrueshme të Maturës; nëse nota do të jetë sërisht e njëjtë, merret në konsideratë koha e regjistrimit të aplikantit për të vazhduar studimet në SHLUJ "Universiteti Marin Barleti".

### IV. Për programet e ciklit të dytë Master

- Kriteri i pranimin për vitin akademik 2020-2021 do të jetë ai i vlerësimit të aftësisë të aplikantit në fushën e studimit në formimin pararendës në ciklin e parë Bachelor, ose mbi bazë të aftësive dhe kërkesave të vendit të punës ku është i punësuar aplikanti. Kjo aftësi gjykohet nga Komisioni *ad hoc* i ngritur me vendim të Dekanit të Fakultetit ku është i përfshirë programi që ka zgjedhur aplikanti.
- Renditja e aplikantëve kryhet sipas nivelit më të lartë të notës mesatare në përfundim të programit në ciklin e parë Bachelor dhe nëse nota do të jetë e njëjtë, Komision *ad hoc* vlerëson kualifikimin e aplikantit në raport me programin që ai ndjek.
- Në procesin e pranimin të studentëve Master, Komisionet *ad hoc* prioritet të parë i japin shqyrtimit të kërkesave dhe dosjeve të aplikantëve që kanë përfunduar me sukses studimet e ciklit të parë në SHLUJ "Universiteti Marin Barleti".

Mbi bazën e kërkesës suaj, këto kritere janë përditësuar në portalin U-Albania dhe në faqen zyrtare të web site të SHLUJ "Universiteti Marin Barleti".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin shprehim gatishmërinë për përcjelljen e çdo informacioni tjetër që do të kërkohet nga ana juaj

Me respekt,  
**Prof. Dr. Marenglen SPIRO**  
Rektor i SHLUJ "Universiteti Marin Barleti"



**VENDIM**

**Nr. 5/19, datë 04.02.2019**

**I SENATIT TË SHLUJ "UNIVERSITETI MARIN BARLETI"**

***"Për miratimin e kriterëve e veçanta për pranimin e studentëve të rinj në programet e studimit të ciklit të parë, me karakter profesional dhe të ciklit të dytë për vitin akademik 2020-2021 të ofruara SHLUJ "Universiteti Marin Barleti".***

Senati i SHLUJ "Universiteti Marin Barleti, në mbledhjen e tij me datë 01.02.2019, diskutoi mbi kriteret e veçanta për pranimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2020-2021, sipas porosisë së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dërguar me shkresën Nr. 329 prot., datë 15.01.2019, dhe

***vendosi:***

Miratimin e kriterëve për pranimin e studentëve në programet me karakter profesional, në programet e ciklit të parë Bachelor dhe në programet e ciklit të dytë Master, për vitin akademik 2020-2021, të miratuara nga Senati Akademik, si më poshtë vijon:

***I. Për programet me karakter profesional***

1. Kriteri i pranimit për aplikim në të gjitha programet e studimit me karakter profesional është nota mesatare e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2020-2021.
2. Renditja e aplikantëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare bëhet sipas nivelit më të lartë të notës mesatare të përcaktuar në VKM; nëse nota mesatare do të rezultojë e njëjtë për më shumë se 2 aplikantë, do të merret në konsideratë nota më e lartë e provimit të Matematikës në Provimet e detyrueshme të Maturës, me përjashtim të programeve Operator në fitnes, palestër dhe organizime eventesh publike dhe Operator dhe këshillues në përkujdesje shëndetësore, për të cilët do të jetë nota më e lartë e provimit të Gjuhës së Huaj në Provimet e detyrueshme të Maturës; nëse nota do të jetë sërish e njëjtë, merret në konsideratë koha e regjistrimit të aplikantit për të vazhduar studimet në SHLUJ "Universiteti Marin Barleti".

***II. Për programet e ciklit të parë Bachelor***

1. Kriteri i pranimit për aplikim në të gjitha programet e ciklit të parë Bachelor është nota mesatare e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2020-2021.
2. Renditja e aplikantëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare bëhet sipas nivelit më të lartë të notës mesatare të përcaktuar në VKM; nëse nota mesatare do të rezultojë e njëjtë për më shumë se 2 aplikantë, do të merret në konsideratë nota më e lartë e provimit të Gjuhës së Huaj në Provimet e detyrueshme të Maturës, me përjashtim të programit të Edukimit Fizik e Sporte; nëse nota do të jetë sërish e njëjtë, merret në konsideratë koha e regjistrimit të aplikantit për të vazhduar studimet në SHLUJ "Universiteti Marin Barleti" në programin e zgjedhur.
3. Renditja e aplikantëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare në programin e Edukimit Fizik e Sporte bëhet sipas nivelit më të lartë të pikëve të përllogaritur: 50% e pikëve totale (totali = 100



pikë) përcaktohen sipas notës mesatare të përcaktuar në VKM dhe 50% e pikëve përcaktohen nga testi fizik i zhvilluar pranë SHLUIJ "Universiteti Marin Barleti"; nëse totali i pikëve do të rezultojë e njëjtë për më shumë se 2 aplikantë, do të merret në konsideratë nota më e lartë e provimit të Gjuhës së Huaj në Provimet e detyrueshme të Maturës; nëse nota do të jetë sërish e njëjtë, merret në konsideratë koha e regjistrimit të aplikantit për të vazhduar studimet në SHLUIJ "Universiteti Marin Barleti".

### III. Për programet e integruara të ciklit të dytë

1. Kriteri i pranimit për aplikim në programin e integruar të ciklit të dytë në Arkitekturë është nota mesatare e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin akademik 2020-2021.
2. Renditja e aplikantëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare bëhet sipas nivelit më të lartë të notës mesatare të përcaktuar në VKM; nëse nota mesatare do të rezultojë e njëjtë për më shumë se 2 aplikantë, do të merret në konsideratë nota më e lartë e provimit të Matematikës në Provimet e detyrueshme të Maturës; nëse nota do të jetë sërish e njëjtë, merret në konsideratë koha e regjistrimit të aplikantit për të vazhduar studimet në SHLUIJ "Universiteti Marin Barleti".

### IV. Për programet e ciklit të dytë Master

1. Kriteri i pranimit për vitin akademik 2020-2021 do të jetë ai i vlerësimit të aftësisë të aplikantit në fushën e studimit në formimin pararendës në ciklin e parë Bachelor, ose mbi bazë të aftësive dhe kërkesave të vendit të punës ku është i punësuar aplikanti. Kjo aftësi gjykohet nga Komisioni *ad hoc* i ngritur me vendim të Dekanit të Fakultetit ku është i përfshirë programi që ka zgjedhur aplikanti.
2. Renditja e aplikantëve kryhet sipas nivelit më të lartë të notës mesatare në përfundim të programit në ciklin e parë Bachelor dhe nëse nota do të jetë e njëjtë, Komision *ad hoc* vlerëson kualifikimin e aplikantit në raport me programin që ai ndjek.
3. Në procesin e pranimit të studentëve Master, Komisionet *ad hoc* prioritet të parë i japin shqyrtimit të kërkesave dhe dosjeve të aplikantëve që kanë përfunduar me sukses studimet e ciklit të parë në SHLUIJ "Universiteti Marin Barleti".

Për Senatin e SHLUIJ "Universiteti Marin Barleti"

KRYETARI  
Prof. Dr. Marenglen SPIRO  
REKTOR